



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 516/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Fryma e Re (FER).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik FER, ne te cilën pretendohet se “me datë 12.12.2010, ne shkollën fillore Dardania, Prishtine, QV Nr. 1904/06R, rreth orës 17:15minuta vëzhguesja e FER, Aida Hydaverdi është sulmuar fizikisht nga Durim Ahmetaj, anetar i PDK-se. Hydaverdi është ankuar menjëherë dhe është larguar nga pika e vëzhgimit për shkak se është ndier e kërcënuar dhe e fyer përpara syve te te tjerëve”.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, përveç se ka siguruar numër kontakt te Aida Hydaverdit, ne cilësinë e dëshmitarit.

Me rëndësi është fakti se PZAP është informuar prej organeve policore se ne shkollën Dardania QV Nr. 1904 ne lidhje me numër lende A516, zyrtaret policor nuk kane qene te informuar as nga udhëheqësi i QV-se e as nga parashtruesi i ankesës ne lidhje me problematiken e paraqitur ne ankesë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun se nuk është ofruar asnjë dëshmi apo prova të mjaftueshme për të besuar se ka ndodhur shkelja e pretenduar nga subjekti politik FER. Ky fakt konfirmohet edhe përmes organe policore, te cilët theksojnë se ne QV Nr. 1904/06R, dt, 12.12.2010 nuk pasur asnjë problem sigurie te personit dhe për me tepër nuk është parashtruar asnjë ankese ne polici prej parashtruesit te ankesës. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 516/2010 më datën 16.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

